



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-062

Prishtinë, më 28 mars 2019, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 28 MARS 2019

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Elmi Reçica, Ahmet Isufi, Dardan Sejdiu, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi dhe Gazmend Krasniqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Kërkesa e 42 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme,
2. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme,
3. Vazhdimi i seancave me pikat e papërfunduara,
4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Kërkesa e 42 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 42 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 38, pika 2c të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit më 28 mars 2019, në orën 11:00.

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të enjten, më 28 mars 2019, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar mbi situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura, përkatësisht së paku 15 njësi mësimore gjatë grevës 3-javore nga 14 janari deri më 1 shkurt 2019.

2. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit më 28 mars 2019, në orën 14:00, për shqyrtimin e Projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Projektligji për ndalimin e lojërave të fatit është proceduar nga Qeveria më 27 mars 2019 dhe i njëjti u është shpërndarë deputetëve,

ndërsa shqyrtimi i tij në seancë duhet të bëhet me procedurë të përshpejtuar – shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Kryesia, pas diskutimeve vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit e kërkuar nga kryeministri, z. Haradinaj, të mbahet të enjten, më 28 mars 2019, në orën 14:00, përkatësisht menjëherë pas përfundimit të seancës së jashtëzakonshme, e cila do të fillojë në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit

Po ashtu, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin nr. 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancën e jashtëzakonshme, e cila do të mbahet sot, më 28 mars 2019.

3. Vazhdimi i seancave me pikat e papërfunduara

Kryesia vendosi që vazhdimi i seancave plenare me pikat e përfunduara të mbahet të enjten, më 11 prill 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 janar 2019:

- 1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,*
- 2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,*
- 3. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,*
- 4. Votimi në parim i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.*

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 28 shkurt 2019:

- 1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*

2. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
3. *Votimi në lexim të dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
5. *Votimi në rundin e dytë për zgjedhjen e gjashtë (6) anëtarëve të Këshillit për Ndhimë Juridike Falas,*
6. *Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019,*
7. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për pesë (5) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7 mars 2019:

1. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,*
2. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
3. *Votimi i Raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,*
4. *Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,*
5. *Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,*
6. *Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,*
7. *Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,*
8. *Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,*
9. *Votimi për shkarkimin e një (1) anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.*
10. *Votimi i Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,*
11. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.*
12. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,*
13. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.*
14. *Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,*
15. *Votimi në parim i Projektligjit për peticione,*
16. *Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,*

17. *Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
18. *Votimi në parim i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,*
19. *Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve.*
20. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës.*
21. *Miratimi i Deklaratës në lidhje me vëllezërit Bytyqi,*
22. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,*
23. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë,*
24. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,*
25. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat,*
26. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,*
27. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit,*
28. *Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të Procedurës Penale,*
29. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,*
30. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,*
31. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Diasporën,*
32. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës,*
33. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pronën publike,*
34. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike,*
35. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247,*
36. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mos-çaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës,*
37. *Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a./NKEC.*

IV. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 12 mars 2019:

1. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara.*

V. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 13 mars 2019:

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti.

4. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të premten, më 12 prill 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i Propozim-Amendamentit nr. 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit,*
- 5. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,*
- 6. Shqyrtimi i Propozim-programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,*
- 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike,*
- 8. Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,*
- 9. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributëdhënës,*
- 10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI 08/09, dt. 17 dhjetor 2010, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-799, datë 19 mars 2014, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 08/186, datë 29 prill 2014 i hyrë në fuqi më 12 maj 2014 dhe të dy (2) udhëzimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. C-V-14-4099 dhe nr. C-V-14-4332, datë 13 qershor 2014,*
- 11. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti,*
- 12. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse mbi organizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë,*
- 13. Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,*
- 14. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - "KOSTT" sh. a.,*

15. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për kompensimin e anëtarëve të këtij Komisioni,

16. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e zëvendëskryetarit të dytë në Komisionin ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe benificioneve nga sigurimi social,

17. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala, për zgjatjen e mandatit dhe për emërimin e zëvendëskryesuesit të këtij komisioni hetimor.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozim-programi i punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019

Kryesia, Propozim-programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 e radhiti në rend dite të seancës plenare, e cila do të mbahet më 12 prill 2019.

2. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

Kryesia, votimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së e radhiti në rend dite të seancës plenare, e cila do të mbahet më 12 prill 2019.

3. Kërkesa e deputetit Ismajl Kurteshi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të GP të LVV-së, për debat parlamentar në lidhje me përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse mbi organizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë

Kryesia, kërkesën e deputetit Ismajl Kurteshi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të GP të LVV-së, për debat parlamentar në lidhje me përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse mbi organizimin e arsimit parauniversitar në Kosovë e radhiti në rend dite të seancës plenare, e cila do të mbahet më 12 prill 2019.

4. Kërkesa e deputetit Armend Zemaj, mbështetur edhe nga 9 deputetë të GP të LDK-së, për debat parlamentar në lidhje me mosrespektimin e të drejtave të punëtorëve, përfshirë orarin e stërzgjatur të punës, punësimin pa kontrata pune, pagesa jo të rregullta, si dhe mosrespektimi i kushteve të tjera të parapara me ligj për punëtorët që punojnë në sektorin e shërbimeve, qendrave tregtare, sektorin e ndërtimitarisë, hotelarisë dhe tregtisë

Kryesia, shqyrtimin e kërkesës së lartshënuar e shtyri për një mbledhjen tjetër të radhës.

5. Kërkesa për mbulimin e tejkalimit të shpenzimeve për akomodim lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bukuresht (Rumani), nga data 6 deri më 9 mars 2019

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i shpenzimeve të tejkaluara të akomodimit për kryetaren e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bukuresht (Rumani), nga 6 deri më 9 mars 2019, sipas kërkesës së bashkangjitur, me nr. 06/3026/Do-1587, datë 21.03.2019.

6. Kërkesa e kryetarit të Komisionit ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe benificioneve nga sigurimi social për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Komisionit ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe benificioneve nga sigurimi social, për angazhimin e ekspertit në fushën e pensioneve i ndahen mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit, në shumën 1.000 euro.
2. Angazhimi dhe kompensimi i ekspertit nga pika 1 e këtij Vendimi bëhet në pajim me procedurat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-025, datë 19. 4. 2011.
3. Komisionit ad hoc i mbulohen shpenzimet për aktivitetet e tij në bazë të Vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 06-V-023, datë 20 nëntor 2017.

7. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për sigurimin e raportit vjetor financiar të Kuvendit për vitin 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Raportit vjetor financiar i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 i dërgohet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pasi të miratohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

8. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kanada

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Flora Brovina, i lejohet udhëtimi zyrtar në Otava (Kanada), prej 23 deri më 28 prill 2019.

9. Raporti i takimeve IV, V dhe VI të Komisionit të përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE- Kosovë

Kryesia u njoftua me shkrim nga kryesuesi i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin Parlamentar për Stabilizim Asociimin BE-Kosovë, z. Memli Krasniqi, për tri (3) takimet e Komisionit të përbashkët Parlamentar për Stabilizim Asociim BE-Kosovë të realizuara në Prishtinë dhe Strasburg gjatë vitit 2018 dhe në shkurt 2019.

10. Raporti i shpenzimeve të buxhetit të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të buxhetit të Komisioni Hetimor Parlamentar në shumën prej 231.50 euro (dyqind e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë centë) në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

11. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë, nga 18 deri më 20 shkurt 2019.

12. Njoftimi i deputetes Shqipe Pantina për dorëheqjen e saj nga anëtarja dhe nënkryetarja e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryesia u njoftua me shkrim nga deputetja Shqipe Pantina për dorëheqjen e saj nga anëtarja dhe nënkryetarja e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale